



STATUTI

I

SHOQËRISË ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

(M&A 2020 shpk)

Në Tiranë, sot më datë 18.08.2020, me cilësinë e ortakeve themelues te Shoqerise:

Z. Massimo Piazzalunga, shtetas Italian, lindur ne Romë(Itali) më 06/05/1958 dhe banues ne Macedonia në adresën Naroden Front 9/13 Skopje MK, mbajtës i pasaportës me nr. YA8161828,

Z. Ardit Osmëni, lindur me dt . 02/07/1989 , ne Tepelenë , dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. 032449511,

Në cilësinë e “ortakeve themelues”, me vullnetin e lirë, të plotë e të sinqertë dhe iniciativën e lirë private, mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë datë 14.04.2008, “Për Shoqëritë Tregtare”, ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 ”Për Qëndrën Komëtare të Regjistrimit”, në atë doganor, fiskal e tatimor, kane themeluar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin **“M&A 2020 shpk** (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqëria **M&A 2020 shpk.** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKB (Qendren Kombetare te Biznesit), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria **M&A 2020 shpk** , është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaket e cila nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut te vetëm përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaket gezojne kuotën e tyre në shoqëri në perpjestim me kuotën që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqëria e ka selinë në bashkine Rruga e Barrikadave, godina nr. 23, Tirane.

Shoqeria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetem nga Administratoret si edhe të hapë zyra perfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4
Objekti i veprimit tarisë

Tregtim me shumice dhe pakice, import-eksport te mallrave industriale, konfeksiione, kozmetike, buzhuteri, lende te pare per industrine, materiale dhe paisje te ndryshme. Blerjen me qellim te furnizoje me mallra, konfeksiione, veshmbathje, kozmetike, bizhuteri, dhe lende te pare per industrine, ne bashkepunim me shoqeri vendase dhe te huaja si dhe import-eksportin e mallrave te ndryshme qe do te jene objekt i aktivitetit tregetar.

Trasport kombetar dhe nderkombetar, per nevoja te vete shoqerise dhe per te trete. Te krye publikime dhe aktivitete reklamuese. Pjesemarjen dhe organizimin e ekspos italiane, panaireve dhe /ose aktiviteteve te ngjashme, brenda dhe jashtë vendit.

Qiramarrjen, qiradhenien dhe leasing te pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme, mallrave dhe produkteve per realizimin e qellimit kryesor te shoqerise.

Te kontrakoje me persona fizike dhe juridike vendas e te huaj, per gjetjen e tregjeve te reklamimit dhe te shitjes se produkteve te shoqerise. Te fitoje, direkt apo indirekt interesa ne shoqeri te tjera te cilat kane nje objekt te ngjashem me ate te Shoqerise, ne Shqiperi ose jashtë saj. Shoqeria gjithashtu mund te realizoje cdo aktivitet te ligjshem tjeter te cilin ajo e emon te nevojshem per realizimin e qellimeve te saj.

Neni 5
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKB) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore te papercaktuar.

Kreu II
Neni 6
Kapitali Themeltar

Kapitali i shoqërisë është 100.000 Lekë (Njeqind mijë leke te reja), kapitali i shoqërisë ndahet në 2 kuota me vlerat si me poshtë:

- Massimo Piazzalunga (70 shtatedhjete mijë) leke duke perfaqesuar 70% (shtatedhjete perqind) te kapitalit themeltar me te drejte vote
- **Z.Ardit Osmëni**, zoterues i 1 (nje) kuote te kapitalit të shoqërise me vlerë 30.000 leke (tridhjete mijë) leke duke perfaqesuar 30% (tridhjete perqind) te kapitalit themeltar me te drejte vote

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme. Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme ose të paluajtshme apo të drejta)

Ortaket përgjigjen për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri ne vlerën e kontributit të tyre në kapitalin themeltar të shoqërise.

Neni 7:
Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kaptiali i shoqërisë mund te zmadhohet me vendim të ortakeve duke kontribuar në natyrë ose në para dhe shërbime.Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e nje vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit deri në vlerën minimale.

Kërkohet vendim i kualifikuar edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

Neni 8:



Transferimi i kapitalit



Kuotat e kapitalit të një shoqërie më përgjegjësi te kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të përpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, deri ne çastin e regjistrimit të saj në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

Neni 9

Organji Vendimmarrës

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm ne rast se shoqeria eshte e themeluar nga një ortak i vetem. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Pergjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpérndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- m) te bleje, shese, kembeje pasuri te patundshme te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtjohet pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilat nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Neni 10
Administrimi

Administratori i shoqërisë është ARDIT OSMENI emëruar në këtë detyrë për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritje.

Neni 11
Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit.

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përparrë të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallevet. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rr Ethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

ORTAKET E SHOQERISE

MASSIMO PIAZALUNGA

Massimo Piazzalunga




ARDIT OSMENI

Ardit Osmeni



Data 18/08/2020



REPUBLIKA E SHQIPERISE

Notere: SANJA A. TELHALLARI (PORJA)

Rruga "Teodor Keko", Unaza e Re, Kati 0, poshte Bar. "Orkidea", Tirane

Mob. 067 20 22 444; email: sanja40@live.com

Nr. 7538 Rep.

VËRTETIM NENSHKRIMI

(NE AKTET E SHOQERIVE TREGTARE, SHPK)

(STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR)

Sot më datë, **19.08.2020** (Dymije e Njezete), para meje Noteres Sanja A.Telhallari (PORJA), Notere në Dhomën e Noterisë Tiranë, me Seli në Rr. "Teodor Keko" u paraqitën personalisht:

- **Z.Massimo Piazzalunga**, shtetas Italian, lindur ne Romë(Itali) më 06/05/1958 dhe banues ne Macedonia në adresën Naroden Front 9/13 Skopje MK, mbajtës i pasaportës me nr. YA8161828,
- **Z. Ardit Osmëni**, lindur me dt .02/07/1989, ne Tepelenë, dhe banues ne Tiranë, madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar nga Karta e Identitetit Nr. 032449511.

Une noterja pasi u sigurova se nenshkrimi i vendosur ne Statutin e Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar "M & A" SHPK, me date 18.08.2020, eshte nenshkrim i ortakeve te kesaj shoqerie Z. Massimo Piazzalunga me 70% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerie dhe i Z.Ardit Osmeni me 30% te pjeseve te kapitalit te kesaj shoqerie te cilet e nenshkruan ne prezencen time noteres.

Une noterja se ortaket e kesaj shoqerie e nenshkruan Statutin e kesaj shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar ne pranine time noteres, duke nenshkruar ne menyre te sakte dhe te rregullt, dhe sa me siper une noterja vertetoj se nenshkrimi ne dokumentin bashkelidhur ketij vertetimi eshte i sakte i vendosur ne baze te dispozitave ligjore ne fuqi, dhe vertetoj rregullsine e tyre.

Sa me siper leshohet ky Vertetim nenshkrimi per te vertetuar nenshkrimet e ortakeve te kesaj shoqerie me Pergjegjesi te Kufizuar ne Statutin te shoqerise "M & A" shpk.

Unë Noterja vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj te ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve ,me cilesine qe me njeh *neni nr.128 i Ligjit nr.110*, date 20.12.2018 "Per noterine" ne Republikën e Shqiperise.

Për të vërtetuar sa më sipër u hartua ky akt notarial i cili si u lexua dhe u gjet sipas vullnetit të porositësve u nënshkrua në praninë time, sipas ligjit dhe unë Noterja e vërtetoj atë rregullisht.

—Tiranë, me 19.08.2020

NOTE RE
SANJA A.TELHALLARI (PORJA)